



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/05/2022 Ref.: 651/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 99-të, të mbajtur më 13.05.2022, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji Universum kampusi kryesor në Prishtinë në nivel institucional, për periudhën pesë vjeçare 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### A r s y e t i m i

I. Kolegji Universum, kampusi kryesor në Prishtinë, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim në nivel institucional. AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Universum, me qëllim të vlerësimit në nivel institucional.

Vizita është organizuar më 08.02.2022, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Magdalena Platis dhe Laura Palac.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji Universum kampusi kryesor në Prishtinë, është vlerësuar se përmbushë: plotësisht shtatë (7) dhe substancialisht katër (4).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen 99 të mbajtur më 23.05.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Universum kampusi kryesor në Prishtinë, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum, kampusi kryesor në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

